

Të nderuar familjarë të nxënësve të Kolegjit “The Independent”. Urojmë të jeni mirë familjarisht!

Me kënaqësi ju lajmërojmë se pasi përfunduar ngarkesën mësimore të mësuesve dhe orarin, infrastruktura e shkollës sonë na e lejon mundësinë që ne të zhvillojmë në ambientet e saj, të gjitha lëndët e kurrikulës të arsimit shqiptar dhe ato të kurrikulës angleze si: Maths (I-XII), Science (I-X), Computer Science (IV-XII). Si dhe për herë të parë edhe Global Perspectives në disa klasa ku na e lejon mundësia si në klasën XI,VII, IV etj.

Po ashtu për herë të parë ne zhvillojmë në gjuhën angleze lëndet Qytetari X, Filozofi XI, Psikologji me zgjedhje XII, Ekonomi XII*te alternuar edhe ne shqip, Teater me zgjedhje në klasen XII.

Oret mësimore do të jenë të plota, dy ore të njëpasnjëshme nga 45 min , pra 90 minuta. Janë marrë të gjitha masat për distancim fizik sipas protokollit për COVID-19

nëpër klasa, në hyrje-daljet të cilat i kemi dërguar me hartën, me disa ndryshime të vogla për klasa te caktuara(I, II dhe të shkollës profesionale) ,për te cilat do të informoheni në komunikimin më të afërt së bashku me videot e çdo klase mësimore dhe kabineteve të cdo lënde, nr i të cilave nuk e kalon 16 nxënës duke ruajtur të gjitha parametrat e protokollit.

Jemi në hapat e fundit të përpunimit të një rregulloreje që nënvizon të gjitha përgjegjësitë e stafit drejtues, stafit mësimdhënës (si mësimdhënës, menaxhues ditor të hyrje-daljeve në kushtet e reja, përgjegjës të mikrobusesave, si dhe përgjegjës kati- dezhurn ditor) dhe për zbatimin e cdo mase të marrë në kuadër të situatës së re.

Po kështu në rregullore nënvizohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e sanitareve, drejtuesit të mjeteve, të punonjësve të kuzhinës dhe çdo pjesëtar të komunitetit të Kolegjit “The Independent” duke përfshirë edhe përgjegjësitë tuaja prindër të nderuar , që duke i zbatuar dhe ju detyrat tuaja do të mbetemi në planifikimin e mësimdhënies në shkollë.

Nëse kemi një rast sëmundje me COVID-19, ajo klasë kalon në mësim online. Ne i kemi marrë të gjitha masat në shkollë që kjo mos të ndodhë por jo gjithcka varet nga ne. Prandaj duhet një bashkëpunim si asnjëherë tjetër me ju, familjarët e shkollës tonë.

Për cdo pyetje apo sugjerim që keni adresohuni me sms ose Whatsapp tek nr 0694808377 ose i sekretares 0696028095 që të shërbejnë për ti pasqyruar në rregullore.

Shumë shpesh do të jemi në kontakt me ju. Familjarve të nxënësve të rinj do t’ju luteshim që ditën e premte, të shtunën e te dielën përkatësisht 11,12,13 shtator të mos planifikojnë largimin nga Tirana në mënyrë që mjetet tona të transportit me mësuesit përgjegjës të tyre, me anë të komunikimit telefonik të mesojnë shtëpitë tuaja, sepse edhe ditën e parë nuk lejohet që prindërit të futen në ambientet e shkollës.

Edhe fëmijët e parashkollorëve apo të klasës së parë dorëzohen nga prindërit në portën kryesore nese I sillni vetë dhe do të priten nga nëndrejtoresha Alma Bakri, e cila do ti sistemojë në ambientin mësimor të përgatitur për ta.